



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR ARSIM

Nr-4- 670/01-55807
Datë: 29 09 2023

Në mbështetje të nenit 8 të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 e datës 26.04.2022, Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15 Nr. 670/01-22599 të datës 28.04.2023 dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës 1Nr. 670/01-52871 të datës 14.09.2023 për caktimin e numrit të bursave dhe shumës financiare për një bursë për studentë për vitin akademik-shkollor 2023/2024, Drejtorati për Arsim i Komunës së Lipjanit shpall:

KONKURS PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Komuna e Lipjanit ndanë 170 (njëqind e shtatëdhjetë) bursa për vitin akademik 2023/2024. Vlera e bursës është 500 € për vitin akademik.

Kushtet dhe kriteret:

1. Të drejtë për të aplikuar për bursë komunale kanë studentët të cilët i plotësojnë këto kushte:
 - Të jenë banorë rezident të Komunës së Lipjanit.
 - Të jenë të regjistruar në vitin akademik për të cilin ndahen bursat (vërtetimi i regjistrimit të semestrit të radhës për vitin akademik të studimeve për të cilin ndahet bursa).
 - Të kenë çertifikatën e notave (në çertifikatën e notave duhet të jetë e precizuar nota mesatare).
 - Studenti/ja, gjatë aplikimit duhet të dorëzojë një deklaratë me shkrim, me të cilën deklaron se nuk është përfitues i ndonjë burse tjetër për vitin e njëjtë akademik për të cilin ndahet bursa.
 - Studentët të cilët kanë përsëritur cilin do vit të studimeve, nuk kanë të drejtë të përfitimit të bursës.
2. Niveli i studimeve për të cilin ndahet bursa është themelore (bachelor), studentë aplikues duhet të jenë të regjistruar së paku në vitin e dytë të studimeve.
3. Drejtimet deficitare vlerësohen me 15 pikë, studentët me nevoja të veçanta, fëmijë i martirëve, veteranëve, invalidëve të luftës, komunitetit jo shumicë dhe me asistencë sociale vlerësohen me 5 pikë.
4. Studentët që kanë pikë të barabarta, përparësi në renditjen e listës së shpallur do t'u epet studentëve që kanë notë më të lartë mesatare.
5. Studentët do të vlerësohen me pikë nga Komisioni duke u bazuar në sukseset e arritura në vitin paraprak në pajtim me kriteret e përcaktuar me dispozitat e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 e datës 26.04.2022 dhe Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15 Nr. 670/01-22599 të datës 28.04.2023.

Bursat do të ndahen sipas këtyre fushave të studimit:

Fushat e studimit	Numri i bursave
Mjekësore dhe sportive	33
Teknike me gjeoshkenca	18
Shkencat matematiko-natyrore	13
Edukim	25
Ekonomi dhe biznes	15
Juridik e administratë	12
Bujqësi, Veterinë e Ushqim	7
Arte	5
Gjuhët dhe Komunikim	22
Shoqërore	10
Shkencat kompjuterike (profilet që nuk janë në FSHMN dhe në Teknik)	10
Gjithsejtë	170 bursa

Drejtimit deficitare:

1. Mjekësi e Përgjithshme
2. Anesteziologji,
3. Matematikë, Fizikë, Kimi, Shkencat Kompjuterike (FSHMN)
4. Termoenergjetikë dhe energji të ripërtëritshme
5. Mekatronikë
6. Automatikë e kompjuterizuar dhe robotik,
7. Elektronikë
8. Inxhinieri kompjuterike
9. Hidroteknikë
10. Inxhinieri e ambientit

Vërejtje: Nëse në ndonjë fushë studimi nuk plotësohet numri i përfituesve të bursave, atëherë i mbetet komisionit vlerësues që bursat e mbetura t'i shpërndajë në fushat tjera, duke filluar sipas renditjes në tabelën tek fushat e studimit.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Ekstraktin e lindjes,
- Kopja e letërnjoftimit,
- Çertifikata mbi vendbanimin,
- Deklaratën e bashkësisë familjare,
- Çertifikatën e notave,
- ID e fakultetit,
- Konfirmimin e llogarisë bankare,
- Dokumentin zyrtar të lëshuar nga organi kompetent si dëshmi se është fëmijë i dëshmorit, invalidit, veteranit dhe martirit të luftës së UÇK, është person me nevoja të veçanta, në asistencë

sociale (Studentët të cilët janë fëmijë të dëshmorit e që studiojnë në Republikën e Kosovës përfitojnë bursën me automatizëm, pavarësisht se a është përcaktuar fusha e studimit apo jo në thirrjen publike të shpallur nga Komuna, nëse plotësojnë dokumentacionin konform thirrjes së shpallur),

Aplikacioni merret në zyrën e pranimi të Komunës dhe dorëzohen në këtë zyrë në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit.

Shënim:

Të gjitha dokumentet duhet të jenë të kompletuara sipas thirrjes së shpallur nga DKA ato të pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen.

Rregulloren për Ndarjen e Bursave për Studentë mund ta gjeni në faqen e Komunës <https://kk.rks-gov.net/lipjan/>.

Drejtori i DKA-së

Rasim Hasani

